



KODI I TRANSMETIMIT PËR MEDIAN AUDIOVIZIVE

(Miratuar me Vendimin e AMA-s, nr. 228, datë 11.12.2017)

HYRJE

Kodi i Transmetimit përmban dhe përcakton parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikat e transmetimeve audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Struktura dhe përmbajtja e Kodit të Transmetimit mbështeten në parimet themelore të veprimtarisë së transmetimeve audiovizive, në standardet më të arrira profesionale bashkëkohore, në normat, kërkesat morale dhe etike, si dhe në praktikën e deritanishme të veprimtarisë audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Ky Kod Transmetimi mban parasysh rolin e rëndësishëm të Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA), si mjete të pavarura informacioni dhe platforma mediatike të zhvillimeve publike, politike e shoqërore, që kryejnë funksion informativ, kulturor, argëtues dhe edukativ, si dhe rolin e funksionin e AMA-s si autoritet rregullator në fushën e transmetimeve audiovizive.

Kodi i Transmetimit ka për qëllim të sigurojë pavarësinë dhe paaësinë e veprimtarisë së OSHMA-ve, duke synuar që ato të bëhen gjithnjë e më të ndërgjegjshme për rolin dhe përgjegjësinë e tyre në transmetimin e programeve, në përputhje me respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me standardet e parimet etike e morale të shoqërisë, me respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të fëmijëve për të qenë të mbrojtur, për t’u shprehur dhe për t’u informuar, në respektimin e privatësisë, dinjitetit, pluralizmit, paaësisë etj.

Në thelb, Kodi i Transmetimit përmban parimet bazë të transmetimit, si dhe rregullon veprimtarinë audiovizive, pothuaj në të gjithë gamën e saj të shumanshme e të larmishme në stadin aktual. Kodi është strukturuar në seksione të ndryshme që përfshijnë parime e rregulla për programet informative, për mbrojtjen e fëmijëve në programet e të gjitha llojeve, kundër dhunës së skajshme në ekran, për komunikimet e ndryshme tregtare, respektimin e dinjitetit, mbrojtjen e të dhënave personale e të personave me aftësi të kufizuar etj.

Rregullat e Kodit të Transmetimit nuk duhet të lexohen apo të zbatohen nga OSHMA-të në mënyrë të izoluar, por brenda kontekstit të Kodit në tërësi, të lidhura ngushtë me kuptimet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

e përgjithshme e të veçanta që ndërveprojnë e plotësojnë njëra-tjetrën në shërbim dhe në funksion të së tërës.

Kodi nuk synon të adresojë të gjitha rastet dhe situatat me të cilat OSHMA-të mund të përballen, duke qenë se disa situata të veçanta mund të mos jenë përmendur në mënyrë specifike në këtë Kod. Shembujt e përfshirë në Kod nuk janë shterues. Megjithatë, parimet, sikurse janë të përshkruara në seksionet e mëposhtme, duhet ta bëjnë të qartë qëllimin për të cilin është hartuar ky Kod, si dhe të ndihmojnë ofruesit e shërbimeve mediatike të bëjnë gjykimet e nevojshme.

BAZA LIGJORE

- 1) Kodi i Transmetimit, i hartuar dhe i miratuar nga AMA, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendos rregullat, standardet dhe praktikën e transmetimit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:
 - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
 - Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
 - Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.
 - Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
 - Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar.
 - Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
 - Udhëzimi nr. 9, datë 15.09.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar.
- 2) Kodi i Transmetimit është hartuar në bazë të kërkesave që lidhen me veprimtarinë audiovizive në Bashkimin Europian, parashikuar nga Direktiva 2010/13 e BE-së (“Audiovisual Media Services Directive”).
- 3) Kodi i Transmetimit është hartuar në zbatim të akteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut:
 - “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore” (e vitit 1998), neni 8, neni 9, neni 10 dhe neni 14.
 - Konventa e OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” (e vitit 1989).



PËRKUFIZIME

Termtat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Fëmijë” është çdo person deri në moshën 18 vjeç.
2. “Këshilli i Ankesave” është struktura e ngarkuar për mbikëqyrjen e respektimit të Kodit të Transmetimit, sipas përcaktimeve të nenit 20 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. “Komunitet me nevoja të veçanta shqisore” është komuniteti me mangësi të pjeshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë që bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit.
4. “Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)” është personi fizik ose juridik, që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.
5. “Përgjegjësi editoriale” është ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe organizimin e tyre në:
 - a) një listë dhe orar, në rastin e shërbimeve të transmetimit të drejtpërdrejtë audioviziv;
 - b) një katalog, në rastin e shërbimeve të programit audioviziv, sipas kërkesës.
6. “Program radio” është tërësia e mesazheve audio që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit radio.
7. “Program televiziv” është tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.
8. “Reklamë” është çdo formë e publikimit të transmetuar kundrejt pagesës ose përfitimeve të tjera nga një sipërmarrje publike ose private apo nga një person për qëllime vetëreklamuese, lidhur me veprimtari të veta tregtare e fitimprurëse, profesionale ose ekspertizë, si dhe për mbështetjen e pajisjes me mallra ose shërbime, përfshirë këtu pasuri të paluajtshme, të drejta e detyrime të tjera, përkundrejt pagesës.

Termtat e tjerë në Kodin e Transmetimit kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



SEKSIONI 1

PARIMET THEMELORE

Parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe të pluralizmit të mjeteve të komunikimit audioviziv janë si më poshtë vijon:

- 1.1 Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, garantojnë e respektojnë lirinë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, parimin e mosdiskriminimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- 1.2 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.
- 1.3 Transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut.
- 1.4 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- 1.5 Transmetimet audiovizive nuk duhet të nxisin urrejtjen, intolerancën, diskriminimin ose të justifikojnë dhunën ndërmjet shtetasve.
- 1.6 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton normat morale dhe etike të shoqërisë, si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit.
- 1.7 Në transmetimet audiovizive respektohen të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.
- 1.8 Në të gjithë llojet e transmetimeve audiovizive të respektohet standardi letrar i gjuhës shqipe.
- 1.9 Veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton veçanërisht të drejtat e personave të komuniteteve me nevoja të veçanta shqisore.
- 1.10 Transmetimet audiovizive respektojnë privatësinë dhe garantojnë të drejtën e përgjigjes.
- 1.11 Transmetimet audiovizive realizojnë një larmi përmbajtjeje dhe informacioni, duke respektuar lirinë e konkurrencës dhe shfrytëzuar mundësitë e zhvillimit teknologjik.
- 1.12 Transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve respektojnë të drejtën e barazisë dhe të mosdiskriminimit.
- 1.13 Transmetimet audiovizive, që përmbajnë elementë të pornografisë apo dhunës së skajshme, duhet t'u nënshtrohen rregullave të veçanta të një sistemi kontrolli, si ai i aksesit të kushtëzuar apo programeve të krijuara. Asnjë përmbajtje pornografike nuk duhet të transmetohet në oraret kur programet ndiqen prej fëmijëve.
- 1.14 Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv duhet të jenë të hapur ndaj ideve, opinionëve, tendencave e kahjeve të ndryshme politike, shoqërore, kulturore e fetare.
- 1.15 Transmetimet audiovizive duhet të ruajnë e të promovojnë veçanësitë etnike dhe trashëgiminë kulturore, artistike e mjedisore, në nivel kombëtar e lokal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1.16 Transmetimet audiovizive duhet të promovojnë dhe të mbrojnë mirëqenien, shëndetin e zhvillimin harmonik moral e fizik të fëmijëve. Parimi i interesit më të lartë për mbrojtjen e fëmijëve duhet të jetë parësor në çdo vendimmarrje për transmetimin, programimin, pjesëmarrjen apo informacionet për ta, në mediat audio dhe/ose audiovizive.

SEKSIONI 2 KËSHILLI I ANKESAVE

- 2.1 Mbikëqyrja e zbatimit të Kodit të Transmetimit, të miratuar nga AMA, është kompetencë e Këshillit të Ankesave, sa i përket respektimit të dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve, të të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet audiovizive.
- 2.2 Këshilli i Ankesave mbikëqyr zbatimin e Kodit të Transmetimit nga çdo OSHMA dhe nga RTSH-ja, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- 2.3 Këshilli i Ankesave mbikëqyr në mënyrë periodike përputhshmërinë e programeve të një transmetuesi të huaj, që tërësisht ose kryesisht u drejtohen publikut brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me legjislacionin në fuqi.
- 2.4 Këshilli i Ankesave, me ekspertizë të pavarur, mund të organizojë anketime të publikut për problemet etike të programeve. Përfundimet që nxjerr nga studimi i anketimeve dhe nga ankesat e publikut ia raporton AMA-s, duke sugjeruar masat për përmirësim. Përfundimet mund të publikohen edhe në mjetet e informimit publik.
- 2.5 Çdo 6 muaj Këshilli i Ankesave boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra, në bazë të pikës 2.4 më sipër, në një buletin të veçantë që botohet nga AMA.

SEKSIONI 3

E DREJTA PËR PRIVATËSI DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE PERSONALE

3.1. Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale. Përfshirja në jetën publike nuk i përjashton individët nga e drejta për privatësi, përveç rasteve kur



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- rrethanat e këtyre mund të ndikojnë në performancën e tyre ose në përshtatjen me rolet publike që mbajnë ose kërkojnë.
- 3.2. Identifikimi i një biznesi apo një individ në mënyrë indirekte apo aksidentale në raportimin e një ngjarjeje me interes publik mund të publikohet, përveç rasteve kur vërtetohet se kjo mund të shkaktojë dëm direkt apo paragjykim ndaj tyre.
 - 3.3. Përveç rasteve me interes të lartë publik, OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë imazhe apo fotografi të individëve të arrestuar në pranga, pa miratimin e tyre paraprak. OSHMA-të duhet të respektojnë veçanërisht të drejtën e individëve për privatësi kur raportojnë mbi grupet e pambrojtura të popullatës, apo mbi situata kur ka ndodhur ndonjë tragjedi, sëmundje apo shqetësim. Gazetari duhet të shmangë çdo formë ngacmimi, ndërhyrje të lirë dhe spekulim që mund të rrisë dhimbjen dhe shqetësimin e atyre që janë përfshirë. OSHMA-të nuk duhet të bëjnë publike identitetin e personave që kanë humbur jetën, apo që janë përfshirë nëpër aksidente, përveç rasteve kur OSHMA-të kanë konfirmuar se anëtarët e familjeve të tyre janë informuar dhe janë të vetëdijshëm për situatën.
 - 3.4. OSHMA-të duhet të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë. Kjo nuk duhet të pengojë OSHMA-të që të raportojnë në mënyrë të drejtë mbi çështjet me interes publik.
 - 3.5. Interesi publik përfshin, por nuk kufizohet vetëm në:
 - i) Zbulimin apo ekspozimin e krimit apo të padrejtësisë serioze.
 - ii) Mbrojtjen e shëndetit publik dhe të sigurisë.
 - iii) Parandalimin e publikut nga mashtrimi me një veprim apo deklaratë të një individ apo organizate.
 - iv) Garantimin për të pasur akses në informacione që lehtësojnë formimin e opinionit të qytetarëve për çështjet politike, ekonomike dhe sociale. Për qëllimet e këtij Kodi, interesi publik, nuk duhet të justifikojë pasaktësitë dhe spekulimet.
 - 3.6. OSHMA-të duhet të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave dhe direktivat e vendosura nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të zbatueshme për përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetareske, letrare apo artistike. Të dhënat e arkivuara në posedim të OSHMA-ve mund të aksesohen, modifikohen apo të fshihen në përputhje me kërkesat ligjore. Megjithatë, OSHMA-të duhet të lejohen të mbajnë të dhëna të tilla për qëllime historike, si pjesë e të dhënave të tyre të transmetimit, dhe për raportimin e çështjeve me interes publik.



SEKSIONI 4

TRANSMETIMI I PROGRAMEVE INFORMATIVE

Veprimtaria informative audiovizive, pavarësisht nga operatori i shërbimit mediatik audioviziv që e ushtron, përbën në të gjitha rastet një shërbim me interes të përgjithshëm publik dhe zhvillohet në zbatim e në përputhje me parimet e kërkesat që vijnë:

- 4.1 OSHMA-të, gjatë veprimtarisë së tyre informative, duhet të respektojnë dispozitat mbi lirinë e shprehjes dhe informacionit, si dhe mbi të drejtat e njeriut, të parashikuara në Kushtetutë, legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore ndërkombëtare, si dhe standardet e institucioneve e organizatave ndërkombëtare që mbulojnë ose punojnë në këtë fushë.
- 4.2 OSHMA-të duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre informative në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Kushtetuta dhe legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të rregullave dhe normave që parashtrihen në këtë Kod.
- 4.3 Informacioni i transmetuar duhet të jetë i vërtetë, i saktë, i balancuar dhe i verifikuar.
- 4.4 Informacioni i transmetuar duhet të respektojë pluralizmin dhe diversitetin e mendimeve, si dhe formimin e lirë të opinionit.
- 4.5 Të gjitha lajmet e transmetuara të publikohen në mënyrë objektive dhe të paanshme.
- 4.6 Gazetarët kanë të drejtë të ruajnë sekretin e burimeve të informacionit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos për publikimin e burimit të informacionit.
- 4.7 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë lajme që cenojnë rregullat e etikës dhe moralit publik, që mund të nxisin vepra penale apo që cenojnë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar.
- 4.8 Transmetimet audiovizive informative nuk duhet të përmbajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të nënkuptojnë mesazhe diskriminuese për shkaqe si: gjinia, raca, mosha, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore ose çdo shkak tjetër.
- 4.9 OSHMA-të, në programet informative, nuk duhet të propagandojnë, për qëllime sensacionale krimin, terrorizmin apo veprimtari të tjera që përdorin dhunën.
- 4.10 OSHMA-të duhet të jenë veçanërisht të kujdesshme në respektimin e të drejtave të fëmijëve në rastet e raportimit të rasteve kur fëmijët janë viktima apo autorë të ngjarjeve të dhunshme, bulizmit, dhunës seksuale, krimeve të rënda etj.
- 4.11 OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që shfaqin ose komunikojnë dhe nxisin tek fëmijët sjellje të dhunshme dhe pornografike, pjesëmarrjen e tyre në konflikte etj.
- 4.12 OSHMA-të nuk duhet të çorientojnë publikun, të keqpërdorin apo të shtrembërojnë deklaratat e bëra në kontekste të caktuara.
- 4.13 OSHMA-të kanë akses në informacion, por ai duhet të mblidhet në mënyrë etike e ligjore dhe të raportohet me kulturë gjuhësore e profesionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 4.14 OSHMA-të duhet të marrin në konsideratë ndjeshmërinë e publikut në rastet e fatkeqësive, katastrofave, aksidenteve, duke u dhënë përparësi operacioneve të shpëtimit dhe mbështetjes.
- 4.15 Informacioni i transmetuar nuk duhet të përdoret për përfitime personale dhe përfitime të tjera të drejtpërdrejta, nga ana e pronarëve të mediave audio dhe ose/audiovizive, drejtuesve të tyre dhe gazetarëve.
- 4.16 OSHMA-të, për të shmangur promovimin e padrejtë, gjatë transmetimit të komunikimeve me natyrë tregtare për mallrat, duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit duke mos favorizuar shoqëri të veçanta tregtare ose subjekte tregtarë të lidhura direkt apo indirekt me ortakët apo aksionarët e shoqërive audio dhe/ose audiovizive.

SEKSIONI 5

FËMIJËT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

Çdo fëmijë gëzon të drejtën e marrjes së një informacioni të përshtatshëm, si dhe të drejtën e fjalës, të shprehjes së mendimit dhe të marrjes në konsideratë si një individ me të drejta të patjetërsueshme. Zbatimi i një tërësie parimesh e rregullash, që i japin përparësi interesit të lartë të fëmijës e që vendosin në qendër fëmijën, është mëse i domosdoshëm.

Parime të tjera bazë janë garantimi i mbrojtjes së fëmijëve, e drejta absolute e fëmijës për privatësi, luftimi i paragjykimeve, diskriminimit dhe stereotipeve në shoqëri, vërtetësia dhe saktësia e konfirmuar e raportimit të ngjarjeve që lidhen me fëmijët, e drejta e pjesëmarrjes së fëmijëve, si dhe parimi shumë i rëndësishëm që e vendos median në shërbim të fëmijëve.

Për realizimin dhe zbatimin e parimeve të mësipërme nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv duhet të mbahen parasysh rregullat që vijojnë:

Identifikimi i fëmijës

- 5.1 OSHMA-ve u ndalohet çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, përveç rasteve me interes publik.
- 5.2 Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare. Ndalohet intervistimi i fëmijës që mund të jetë përfshirë në një ngjarje të rëndë: p.sh, fëmijë të larguar nga familja, që kanë tentuar të vrasin veten, që janë përdorur nga grupe kriminale, që kanë qenë brenda një rrjeti prostitucioni, që i kanë prindërit të dënuar.
- 5.3 Në rastet e parashikuara në pikat 5.1 dhe 5.2 më sipër, duhet përdorur teknologjia e përshtatshme që mundëson fshehjen e identitetit me pamje ose zë të fëmijës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 5.4 Të dhënat e publikuara për fëmijët në media duhet të shmangin: identifikimin dhe inicialet e fëmijës; identitetin e prindërve, apo të çdo të afërmi që bën të mundur identifikimin e fëmijës; rrethana, detaje mbi ngjarjen, që bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës, cenojnë dinjitetin e tij dhe nuk i shërbejnë interesit publik; emër shkollë, kopshti, institucioni në rastet kur situata e abuzimit apo veprës penale nuk kanë ndodhur në institucion; emrin e autorit të krimit, i cili ka marrëdhënie gjaku me viktimën.
- 5.5 Kujdes duhet treguar edhe me raportimin dhe transmetimin e palëve të treta jo-fëmijë, kur kjo mund të çojë në identifikimin direkt ose indirekt të fëmijës, sipas pikave 5.1 dhe 5.2 të sipërpërmendura.
- 5.6 Pamjet apo imazhet e fëmijëve ndalohet të merren në mënyrë të fshehtë. Ato duhen marrë me dijeninë dhe pëlqimin me shkrim të prindërve të tij ose kujdestarit ligjor të fëmijës, pasi t'u jetë shpjeguar qëllimi dhe sesi do të përdoren ato.
- 5.7 OSHMA-të duhet të shmangin transmetimin e pamjeve degraduese të fëmijëve dhe në vend të tyre duhet stimuluar transmetimi i pamjeve pozitive të fëmijëve.
- 5.8 OSHMA-ve u ndalohet transmetimi i pamjeve të fëmijëve me nuancë seksuale apo që paraqet fëmijën në pozicione të papërshtatshme; duhet të shmangin transmetimin e pamjeve të fëmijëve në situata dhe mjedise që përcjellin mesazhe denigruese, kur fëmija është i identifikueshëm.
- 5.9 OSHMA-të duhet të kenë rregulla të forta për arkivimin dhe shpërndarjen e materialeve dhe filmimeve me fëmijë, duke kufizuar dhe parandaluar mundësitë e abuzimit me këto materiale.

Intervistimi i fëmijës

- 5.10 Intervistimi i fëmijëve duhet të bëhet me praninë e përfaqësuesit të tij ligjor ose një personi të caktuar prej tij.
- 5.11 Fëmijës si dhe përfaqësuesit ligjor duhet t'i shpjegohet paraprakisht qëllimi i intervistës, si dhe përdorimi i mundshëm i saj. Si për fëmijën, ashtu edhe për përfaqësuesin ligjor, duhet të respektohet e drejta e tyre për të mos pranuar të intervistohen.
- 5.12 Në rast se përfaqësuesi ligjor refuzon intervistimin e fëmijës, atëherë intervista mund të kryhet vetëm nëse fëmija insiston dhe gazetari ka një arsye konkrete të mendojë që intervistimi i shërben interesit të fëmijës. Në këtë rast, gazetari nuk mund ta realizojë i vetëm intervistën me fëmijën, por duhet të kërkohet dhe prania e psikologut, punonjësit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mësues shkollë, edukatorë etj.
- 5.13 Në asnjë rast gazetari nuk ushtron presion, bën premtime apo jep dhurata fëmijës apo përfaqësuesit të tij ligjor me qëllim mundësimin e intervistimit.
- 5.14 Nëse është e nevojshme, gjatë intervistimit të fëmijës, gazetari mund të kërkojë asistencën e një psikologu apo punonjësi social të specializuar.
- 5.15 Intervista duhet të zhvillohet në një mjedis të përshtatshëm, ku fëmija ndihet i lirë dhe jo nën presion. Duhet të shmangen intervistimet dhe filmimet e gjata që lodhin dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- ndikojnë negativisht tek fëmijët, si dhe përsëritja pa arsye të forta, e intervistimit dhe filmimit të të njëjtit fëmijë.
- 5.16 Pyetjet duhet të jenë të qarta e të drejtpërdrejta dhe nuk duhet t'i sugjerojnë përgjigjen fëmijës.
- 5.17 Duhet të shmangen pyetjet ose komentet paragjyquese, të rrezikshme për fëmijën, ose ato që i sjellin ndërmend ngjarje traumatike.
- 5.18 Nëse gjatë intervistimit, gazetari vihet në dijeni për një vepër penale të kryer ndaj fëmijës apo që rrezikon fëmijën, gazetari dhe OSHMA njoftojë menjëherë organet përkatëse.
- 5.19 Në rast se gjatë intervistimit, gazetari vihet në dijeni për fakte, bërja publike e të cilave mund të rrezikojnë jetën, shëndetin, arsimimin, mirëqenien fizike, emocionale, morale të fëmijës, intervista apopjesë e saj nuk duhet të transmetohet.
- 5.20 OSHMA-të duhet të shmangin intervistimin dhe transmetimin e intervistave për fëmijë, viktima të abuzimit seksual dhe të formave të tjera të abuzimit, përveç rastit kur transmetimi i intervistës mund të jetë në interesin më të lartë të fëmijës dhe njëkohësisht në interesin publik.

Reklamat dhe fëmijët

- 5.21 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë reklama që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve. OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë reklama të shërbimeve dhe produkteve, që paraqesin rrezik për zhvillimin fizik, mendor dhe moral të fëmijëve.
- 5.22 OSHMA-të nuk duhet të transmetojnë në programet për fëmijë reklamat e kategorive të veçanta të ushqimeve dhe pijeve që konsiderohen se janë të dëmshme për ta, veçanërisht atome përmbajtje të lartë yndyre, sheqeri, kripe etj.
- 5.23 OSHMA-të duhet të kontrollojnë përmbajtjen e reklamave dhe promocionit të programeve, sidomos të reklamave me dhe për fëmijët, duke garantuar që çdo fëmijë apo imazh fëmije që përdoret në reklama të jetë i shoqëruar me lejen me shkrim të prindit ose përfaqësuesit ligjor të fëmijës.
- 5.24 OSHMA-të duhet të sigurojnë që përfshirja e fëmijëve në reklama të mos paraqesë rrezik për edukimin, shëndetin dhe zhvillimin e tyre fizik e mendor.
- 5.25 Reklamat nuk duhet t'i paraqesin fëmijët në situata, qëndrime e veprime të dëmshme, të rrezikshme, të dhunshme apo vetë-agresive.
- 5.26 Reklamat nuk duhet të paraqesin fëmijë, apo të rritur në prani të fëmijëve duke konsumuar alkool, duhan apo substanca të tjera të dëmshme.
- 5.27 Fëmijët nuk duhet të paraqiten drejtpërdrejt në blerjen e produkteve që reklamohen, pasi mund të abuzohet me besimin dhe mungesën e përvojës së tyre.
- 5.28 Reklamimi i një shërbimi apo produkti nuk duhet të nënkuptojë që mungesa e tij do ta vendosë fëmijën në pozita inferiore apo diskriminuese nga të tjerët.
- 5.29 Reklamat për fëmijët duhet të përmbajnë gjuhë të përshtatshme me aftësitë/kapacitetet e moshës së cilës i drejtohet reklama.



Programet kulturore argëtuese, filmat dhe fëmijët

- 5.30 OSHMA-të nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor, ose moral të fëmijëve, në veçanti filma apo programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale.
- 5.31 OSHMA-të, në programet kulturore e argëtuese, veçanërisht në paraqitjen e sjelljeve të dhunshme dhe seksuale, duhet të tregojnë kujdesin e duhur ndaj ndjeshmërisë të publikut dhe efekteve të programeve të tilla në zhvillimin moral, mendor e fizik të fëmijëve.
- 5.32 OSHMA-të duhet të planifikojnë në orare të përshtatshme programe të posaçme kulturore dhe argëtuese për fëmijët.
- 5.33 OSHMA-të duhet të zbatojnë me përpikëri kërkesat etike – morale dhe të mbrojnë të drejtat e fëmijëve në programet kulturore argëtuese për fëmijë.
- 5.34 OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 22.00 - 06.00)
- 5.35 Kur programe me përmbajtje që mund të dëmtojë fëmijët transmetohen në formë të hapur ato duhet të paraprihen nga një paralajmërim akustik ose të identifikohen nga prania e një simboli viziv gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre.
- 5.36 OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh shkallën e dëmit së shkaktuar nga paraqitja e ndonjë lloj materiali që dëmton fëmijët, në programe përgjithësisht ose në programe të një natyre të caktuar.
- 5.37 OSHMA-të duhet të mbajnë parasysh kërkesat e fëmijëve ndaj transmetimeve audiovizive në sasi e cilësi, si për të shmangur rrezikun e varësisë së fëmijës ndaj televizionit, ashtu edhe për të mos imituar modelet televizive.
- 5.38 OSHMA-të duhet të trajtojnë me respekt, dinjitet e profesionalizëm të gjithë fëmijët që marrin pjesë në programet audiovizive.
- 5.39 OSHMA-të nuk duhet të lejojnë, në programet e tyre, përdorimin e fëmijëve me probleme patologjike apo me aftësi të kufizuara për qëllime propagandistike apo për çdo qëllim tjetër që abuzon me të drejtat e tyre.
- 5.40 OSHMA-të janë të detyruara të vendosin shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve, në çdo program të transmetuar, veçanërisht në filmat dhe programet me përmbajtje e skena problematike.
- 5.41 OSHMA-të duhet të tregojnë kujdes të veçantë për gjuhën dhe komunikimin etik në programet argëtuese, në spektaklet e organizuara me dhe për fëmijët.
- 5.42 OSHMA-të, në rastin e Shërbimeve Mediatike Audiovizive në bazë të kërkesës (on demand), duhet të transmetojnë në formë të koduar programet që mund të dëmtojnë rëndë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve. OSHMA duhet të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror.
- 5.43 Në transmetimet e filmave, OSHMA-të duhet të zbatojnë kërkesat e ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë”, i ndryshuar.



Shenjat paralajmëruese për mbrojtjen e fëmijëve në programet audiovizive

- 5.44 Për programet që transmetohen në fashën orare 19.00 – 22.00, bëhet i detyrueshëm përdorimi i shenjave paralajmëruese për programet që cenojnë e dëmtojnë fëmijët.
- 5.45 OSHMA-të duhet të transmetojnë programet e përcaktuara në pikën 5.41 më sipër, me shenjën përkatëse, e cila duhet të shfaqet në ekran, në një vend të dukshëm, me ngjyrë të qartë e të dallueshme.
- 5.46 OSHMA-të duhet të përgatisin transmetimin e filmave apo programeve të përcaktuara në pikën 5.41 me shenjën përkatëse (kur programi vetë nuk e përcakton), duke u mbështetur në vizionimin paraprak të programit, sipas kriterëve, standardeve e rregullave të Kodit të Transmetimit.
- 5.47 Shfaqja e shenjës paralajmëruese në ekran bëhet menjëherë me fillimin e programit apo filmit dhe e shoqëron atë gjatë gjithë kohës së transmetimit. Shenja paralajmëruese rishfaqet para dhe pas të gjitha ndërprerjeve të programit në vijim, deri në përfundim të tij.
- 5.48 Llojet e shenjave paralajmëruese, që do të përdoren nga OSHMA-të do të jenë tre:
- A. Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë të kuqe*, për përmbajtje që transmetohen vetëm pas orës 22.00, me skena të rënda dhune, psikologjike e fizike, seksuale, me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.
 - B. Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë portokalli* për përmbajtje, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.
 - C. Shenjë paralajmëruese me *ngjyrë të gjelbër*, për përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshirë edhe fëmijët.
- 5.49 OSHMA-të mund të përdorin forma të ndryshme të zgjidhjes grafike për shenjat paralajmëruese, për shembull kategorizim grup moshe, por ngjyra dhe qartësia e shenjës janë elementë të pandryshueshëm dhe të detyrueshëm për të gjithë.

SEKSIONI 6

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

- 6.1 OSHMA-të duhet të luajnë rol të rëndësishëm për të dhënë një imazh të respektuar të personave me aftësi të kufizuara në transmetimet audiovizive. OSHMA-të kombëtare detyrohen që të përdorin gjuhën e shenjave në të paktën një prej edicioneve të lajmeve, me qëllim garantimin e të drejtës së informimit për personat me nevoja të veçanta shqisore.
- 6.2 OSHMA-të kanë për detyrë të tërheqin vëmendjen dhe të sensibilizojnë shoqërinë dhe institucionet e ndryshme për përgjegjësinë ndaj personave me aftësi të kufizuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 6.3 OSHMA-të duhet të promovojnë përpjekjet e shoqatave dhe personave me aftësi të kufizuar për integrimin e tyre në jetën shoqërore.
- 6.4 OSHMA-të duhet të sigurojnë trajtim të drejtë dhe objektiv të personave me aftësi të kufizuar në programet e tyre: jo mëshirë, as denigrim, por vlerësim dhe inkurajim.
- 6.5 OSHMA-të nuk duhet të lejojnë përdorimin e imazhit të personave me aftësi të kufizuar për publicitet apo reklama.
- 6.6 Transmetimet audiovizive nuk duhet të paragjykojnë, të përdorin apo të identifikojnë persona me aftësi të kufizuar, për të mosdëmtuar interesat dhe të drejtat e tyre.
- 6.7 OSHMA-të nuk duhet të shfrytëzojnë ndjeshmërinë e publikut ndaj personave me aftësi të kufizuar për përfitime apo qëllime komerciale.
- 6.8 OSHMA-të duhet t'i trajtojnë me etikë maksimale pamjet e personave me aftësi të kufizuara: s' duhet të paraqiten me detaje gjymtimet e tyre dhe fjalori i gazetarëve duhet të respektojë dinjitetin e tyre.

SEKSIONI 7

REKLAMAT NË TRANSMETIMET AUDIOVIZIVE

- 7.1 Transmetimi i reklamave nga OSHMA-të duhet të mbajë parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi, veçanërisht për reklamat e ndaluara si dhe reklamat e fshehura.
- 7.2 OSHMA-ve u ndalohet të përdorin gjatë transmetimit të reklamave, mënyra të joshjes së shikuesve në mënyrë të pandërgjegjshme dhe teknika për sugjestionimin e tyre.
- 7.3 OSHMA-të nuk duhet të pranojnë apo të transmetojnë reklama që nxisin diskriminimin, që nuk respektojnë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut.
- 7.4 Reklamat nuk duhet të nxisin apo të shtyjnë fëmijët të blejnë apo të marrin prodhime ose shërbime, duke i nxitur drejtpërsëdrejti për të kërkuar nga prindërit ose të tjerë persona të afërm t'u marrin mallrat apo shërbimet e reklamuar, ose të shfrytëzojnë pozitën e fëmijëve në raport me prindërit, mësuesit ose persona të tjerë të afërm të tyre.
- 7.5 Reklamat në transmetimet audiovizive për produktet farmaceutike apo produktet mjekësore që jepen vetëm me recetën e mjekut, janë të ndaluara.
- 7.6 Reklamat në transmetimet audiovizive për trajtimet mjekësore janë të ndaluara. Ndalohet qëmjeku të merret me reklamë të çfarëdo lloji, me përjashtim të rasteve kur këto kanë qëllim shkencor apo edukativ.
- 7.7 Ndërprerjet për komunikimet me natyrë tregtare në programe të ndryshme duhet të respektojnë kohën e përcaktuar për reklamë në raport me programet e tjera, si dhe duhet të respektojnë normat dhe kërkesat e etikës së komunikimit.

SEKSIONI 8

HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- 8.1 Kodi i Transmetimit hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- 8.2 Kodi i Transmetimit publikohet menjëherë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në faqen zyrtare të internetit www.ama.gov.al.